



GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA RAHOVEC-DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Labinot Berisha nga fshati Dejnë, komuna e Rahovecit, për shkak të kundërvajtjes nga neni 5,6 paragrafi 1.3 dhe neni 9 të Ligjit nr.04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, dhe në bazë të nenit 195 dhe 199, të Ligjit mbi kundërvajtjet, më 01.10.2013, mori këtë

A K T V E N D I M

I PANDEHURI: Labinot Mon Berisha, i lindur më 01.01.1982, në fshatin Dejnë, komuna e Rahovecit, ku dhe tani jeton, Shqipëtar, shtetas Kosovar, i punësuar, i gjendjes së mesme ekonomike, gjer me tani i pa denuar,

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S

Sepse deri më datën 31.03.2012, nuk ka përmbushur obligimin ligjor për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë, por formular për deklarimin e pasurisë i ka dorëzuar me vonesë.

Me veprime të këtilla ka kryer kundërvajtjen nga neni 9 e sanksionuar sipas nenit 17 të Ligjit Nr.04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin dhe prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, por gjykata duke aplikuar nenin 10 të LMK-së, i shqiptohet

Q O R T I M I

Me bindje se edhe me këtë masë do të arrihet qëllimi i dënimit.

I pandehuri lirohet nga paushalli gjyqësor, konform nenit 113 të Ligjit mbi kundërvajtjet.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së Agjencionit Kundër Korrupsionit në Prishtinë, me nr.01-2532/12, të datës 13.07.2012, është inicuar procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit Labinot Berisha nga fshati Dejnë, për shkak të kundërvajtjes të përshkruar si në hyrje të këtij aktvendimi.

Gjatë procedurës i pandehuri është marrur në pyetje i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se shënimet në kërkesë janë përsërisht të vërteta duke shtuar se është e vërtetë se deklarimin e pasurisë e ka bërë me vonesë për arsye se në atë kohë ishte në Shqipëri, por menjëherë pastaj ka deklaruar pasurinë në momentin kur i ka marrë formularët i mka përkotësuar dhe personalisht i ka dorëzuar duke i prezentuar gjykatës formularin për deklarimin e pasurisë për vitin 2012. Pastaj në veb faqe të internetit të Agjencionit Kundër Korrupsionit figuron se e ka deklaruar pasurinë për vitin 2012. I pandehuri në fjalën e vet të fundit kërkoi nga gjykata të ketë parasyshtë të gjitha këto për vonesat dhe të mere parasyshtë rrethanat lehtësuese, është hera e parë që ka bërë një lëshim, m dhe se me këtë kundërvajtje nuk janë shkaktuar pasoja.

Gjykata pas administrimit të provave, kërkesës së organit për iniciimin e procedurës, deklarates e të pandehurit, dhe në bazë të provave të tjera të shkresave të lëndës ka konstatuar se i pandehuri me të vërtetë ka kryer kundërvajtje të mosdeklarimit të pasurisë duke u vonuar, por nga provat në shkresat e lëndës dhe nga të dhënat në veb faqen të Agjencionit del se i pandehuri me kohë nuk i ka dorëzuar formularin por këtë e ka bërë me vonesë pikërisht më datën 11.05.2012 kur dhe i është dorëzuar Agjencionit Kundër Korrupsionit, andaj gjykata gjeti se nuk janë shkaktuar pasoja nga vepra kundërvajtëse me deklarimin e pasurisë për një muaj vonesë, të cilën i pandehuri menjëherë e ka evituar, dhe me përgjegjësi të Agjencionit i ka dorëzuar personalisht formularët për deklarimin e pasurisë, dhe mu për këtë gjykata duke i marrë parasyshtë të gjitha rrethanat ia shqiptoi masën e QORTIMIT duke menduar se dhe me këtë masë do të arrihet qëllimi dhe se i pandehuri në të ardhmen nuk do të kryej keso kundërvajtje, dhe duke aplikuar nenin 10 të LMK-së i shqiptoi masën e Qortimit si në dispozitiv.



Me rastin e shqiptimit të këtij dënimi-mase janë marrë parasyshtë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato se nuk janë shkaktuar pasojat, ka evituar menjëherë Gabimin dhe i pandehuri deri më tani asnjherë nuk kundërvajti të kësaj natyre apo të ngjajshmei dhe ato rënduese e krejt konform dispozitave të nenit 7 të Ligjit mbi kundërvajtjet.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor u muar ne baze te nenit 113 të LMK-se.

Me sa u tha mbi e siper eshte vendosur si ne dispozitiv te ketij aktvendimi.

GJYKATA THEM, ELORE GJAKOVË-DEGA RAHOVEC

Regj. I nr.04-316/2012 të datës 01.10.2013.

Gj y q t a r i,
Flamur Hasku



UDHEZIMI JURIDIK: Kunder ketij aktvendimi mund te ushtrohet ankese ne afat prej 8 diteve nga dita e pranimit te aktvendimit Gjykates se Apelit tje ne Prishtine, nepermjet kesaj gjykate.